



Dokleida Kenepe
Sch. HE-se
30/04/25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 125 / Prot.

Vlorë më, 29.4.2025

VENDIM

Nr. 51, datë 29.04.2025

PËR

**RIÇELJEN E PROCESIT TË VETË-KANDIDIMIT PËR ANËTARË TË KËSHILLIT
TË ETIKËS NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 44, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 28 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 29.04.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë riçeljen e procesit të vetëkandidimit për anëtarë të Këshillit të Etikës në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.
2. Periudha e vetëkandidimit të jetë **29.04.2025** deri më **15.05.2025**.
3. Përbërja dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtarë të Këshillit të Etikës janë si vijon:
Bazuar në pikën 2 të nenit 28 të Statutit të UV-së, "Këshilli i Etikës" përbëhet nga,
 - 7(shtatë) anëtarë, 4(katër) prej të cilëve personel akademik me kohë të plotë, nga një për çdo fakultet, që mbajnë të paktën gradën shkencore "Doktor".
 - 1(një) përfaqësues nga radhët e personelit ndihmës akademik,
 - 1(një) nga personeli administrativ,
 - 1(një) përfaqësues nga radhët e studentëve.
 - Kandidati për anëtar vetëkandidohet dhe zgjidhet nga Senati Akademik, me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve dhe votim të fshehtë.
 - Çdo njësi kryesore nuk mund të përfaqësohet me më shumë se një anëtar në Këshillin e Etikës.
 - Mandati i anëtarit të Këshillit të Etikës është 5 (pesë) vjet.
4. Dokumentacioni që kandidatët për anëtarë të Këshillit të Etikës duhet të dorëzojnë janë si vijon:
Dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga kandidatët personeli i UV-së është si më poshtë:
 - a. Kërkesë për vet-kandidim për anëtar të Këshillit të Etikës
 - b. Curriculum Vitae



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- c. Kopje e gradës shkencore apo titullit akademik më të lartë që zotëron (personeli akademik).

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga kandidatët Student është si më poshtë:

- a. Kërkesë për vet-kandidim për anëtar të Këshillit të Etikës
 - b. Vërtetim studenti
 - c. Listë notash (mesatarja mbi 9)
5. Këshilli i Etikës do të vazhdojë të përmbushë misionin e tij deri në konstituimin e Këshillit të ri të Etikës.
6. Vendimi t'i njoftohet gjithë personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ, Këshillit të Etikës aktual dhe Këshillit studentor në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AURELA SALIAJ

